




Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	04.03	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	1181/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.70/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.70/2022 të datës 28.01.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga Komunën e Hanit të Elezit, kundër masës disiplinore Vërejtje me Shkrim Nr.03/256/2022 të datës 12.01.2022 të shqiptuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje me shkrim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 70/2022 e datës 28.01.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me numër 03/Nr.369/2022 i datës 28.01.2022 i Komisionit të Ankesave të Komunës së Hanit të Elezit.

III. Anulohet masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim” me Nr. 03/256/2022 e datës 22.01.2022 e nxjerr nga Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Hanit të Elezit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nda dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi dhe të bëjë shuarjen e masës disiplinore të ankuesit nga dosja personale.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Hanit të Elezit sipas Akt Emërimit me numër 01Nr.9861/2015 të datës 06.10.2015 në pozitën "Zyrtar i Depos", Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme e Komunës së Hanit të Elezit më datë 12.01.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me Shkrim".

Fillimisht ankuesi kundër kësaj mase më datë 17.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në Komunën e Hanit të Elezit, pastaj më datë 28.01.2022 fizikisht ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 385/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Hanit të Elezit. Më datë 04.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Hanit të Elezit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:385/2022 të datës 28.01.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 17.01.2022 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave; Vërejtjen me Shkrim e datës 12.01.2022; Dosjen e pushimit vjetor me numër 02-03Nr.9744/2021; Akt Emërimit me numër 02Nr.9861/2015 në emër të ankuesit; Urdhrin për shfrytëzimin e automobilin të udhëtarëve për punë zyrtare i datës 06.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike i datës 25.11.2021; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Depos" i datës 06.10.2015; Letërnjoftimin e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 04.02.2022; Vendimin me numër 02nr.760/2022 i datës 03.02.2022 mbi deklarin e statusit të nëpunësit; Deklaratën e datës 02.02.2022 nga ankuesi; Vendimin e datës 28.01.2022 i Komisionit të Ankesave; Forografi; Provat shtesë e datës 03.02.2022 nga ankuesi; Vendimin me numër 03/Nr.369/2022 të datës 28.01.2022 të Komisionit të Ankesave të Komunës së Hanit të Elezit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e bazuar, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që masa disiplinore vërejtje me shkrim e shqiptuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit është në



kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk ka këshillë juridike, dhe është tendencioze; shpërndarjen e kalendarëve e kam bërë nga mirëbesimi jo që e kam pasur në përshkrim të detyrave të punës.

Bazuar në provat e lëndës, respektivisht në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Depos” të datës 06.10.2015 janë përcaktuar detyra kryesore të punës si: **Detyra 1.** është përgjegjës për organizimin e depos në përputhje me procedurat dhe politikat e organizatës. **Detyra 2.** Mban evidenca të sakta dhe të plota të mallit në kopje fizike dhe elektronike dhe ruan të gjitha të dhënat relevante të mallit. **Detyra 3.** Bën pranimin e mallit, kujdeset për mirëmbajtjen dhe bënë shpërndarjen sipas kërkesave. **Detyra 4.** Vlerëson dhe kujdeset për hapësirën e nevojshme për deponim të mallit dhe përgatit planet e deponimit të mallrave të ardhshme. **Detyra 5.** Përgatit raporte të rregullta për stoqet e mallrave në depo. **Detyra 6.** Përgatit gjitha procedurat dhe hapat e nevojshme për asgjësimin e mallrave. **Detyra 7.** Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë herë pas here nga mbikëqyrësi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që masa disiplinore vërejtje me shkrim e shqiptuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk ka këshillë juridike, dhe është tendencioze, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Drejtuesha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Komunën e Hanit të Elezit masën disiplinore “vërejtje me shkrim” e ka shqiptuar me arsyetimin që e ka lënë hapur automjetin zyrtar me rastin e shpërndarjes së kalendarëve.

Lidhur me këtë çështje juridike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se fillimisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil, në rastin e shqiptimit të masës disiplinore duhet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, siç parashihet me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-116 për Zyrtarët Publikë. Neni 46 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka paraparë së cilat konsiderohen shkeljet e lehta: **4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”,** në rastin konkret mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit në masën e shqiptuar ndaj ankuesit nuk ka arritur të konstatoj saktë se cilat nga këto shkelje ka bërë ankuesi.

Po ashtu në bazë të provave të lëndës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, nuk ka arritur në mënyrë të drejtë të vlerësoj gjendjen faktike sepse nuk ka arritur të vlerësoj saktë që me lënien e derës hapur të veturës cili është dëmi që i është shkaktuar institucionit, cili është lokacioni i veturës që është lënë hapur, cili zyrtarë është përgjegjës në momentin që vetura dërgohet në parking zyrtarë respektivisht a ka ndonjë përgjegjësi të caktuar zyrtari në momentin që dërgon veturën zyrtare në autoparking të komunës, nuk është vërtetuar që nëse ndaj nëpunësit civil më herët është shqiptuar ndonjë masë disiplinore dhe ende është e pashlyer, dhe po ashtu nuk ka mund të konstatoj nëse

ndonjëherë ankuesit i ka ndodhur ndonjë rast i tillë, rrjedhimisht sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil respektivisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejt me rastin e shqiptimit të masës disiplinore duhet të bazohet në *Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; Shkallën e fajësisë; Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; Përpyekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit*, siç parashihet me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Bazuar në shkresat e lëndës ankuesi nga data 20.12.2021 deri më datë 06.01.2022 ka qenë në pushim vjetor, dhe mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejt e ka ftuar nga pushimi vjetor që të bëjë shpërndarjen e kalendarëve, në këtë rast edhe pse në përshkrimin e detyrave të punës në pikën 7 përcaktohet se: *"Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen herë pas here nga mbikëqyrësi"*, është dashur që të ketë parasysh këtë fakt. Po ashtu me rastin e lënies së derës hapur të veturës zyrtarë nga ana e ankuesit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit është dashur që të konstatoj se ky veprim i ankuesit a ka qenë veprim i qëllimshëm apo kjo është bërë nga pakujdesia dhe ka qenë rast i momentit, si rrjedhojë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesa, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit është masë e rëndë në raport me shkeljen me qenë se nuk është shkaktuar ndonjë pasojë respektivisht dëm i caktuar, në këtë rast mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 13 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Po ashtu mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, të njëjtën nuk e ka arsyetuar në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht me nenin 48 paragrafi 1 dhe të 2, në këtë rast akti me të cilin nëpunësit i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës duhet të përmbajë të gjitha elementet e aktit administrativ siç parashihen me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, kështu që masa disiplinore "vërejtje me shkrim" nuk i përmban elementet e parapara më dispozitat e lartcekura, andaj pretendimi ankimor i ankuesit se masa disiplinore e shqiptuar ndaj tij është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi është i bazuar.

Meqenëse ankuesi më datë 03.02.2022 ka plotësuar ankesën e datës 28.01.2022 duke e dërguar Vendimin me numër 03/Nr.369/2022 të datës 28.01.2022 të Komisionit të Ankesave të Komunës së Hanit të Elezit me të cilin është refuzuar ankesa e tij, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk ka paraparë Komision të Ankesave për nëpunësit civil por vetëm për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës, në këtë rast meqë ankuesi është nëpunës i shërbimit civil, ky komision nuk ka pasur kompetencë të trajtojë këtë çështje juridike, si i tillë është në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, andaj mbi bazën ligjore të potencuar si më lartë dhe duke pasur parasysh se në shkresat e lëndës kemi vendimin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil për ankuesin andaj kolegji nuk u lëshuar në pretendimin sa i përket shkeljeve të ligjit të punës nr.03/L-212 me rastin e dhënies së vërejtjes që është objekt i kësaj anekese.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.70/2022, datë 04.03.2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së;